

PJESA B: KONTRATA

Date: 14.09.2020.

KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

Jetmir Zenelaj B.I.-(N.N.P.” KALAJA”) - Suhareke (në vazhdim “Operatori Ekonomik”), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Renovimi i shkollës fillore ne fshatin Buqe

me numër Identifikues 621-20-4407-2-3-6,dhe nr, te mbrendshem 621-2020-102-236

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Renovimi i shkollës fillore ne fshatin Buqe**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **16.09.2020** dhe përfundon me **16.10.2020**.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **3 ditë** nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i [ekzekutimit të punëve] do të jetë **fshati Buqe**

1.5 Menagjer i kontrates nga AK eshte: Vloran Cenaj

Menagjer i projektit nga AK eshte : Florim Krasniqi

Menagjer i projektit nga OE eshte : Nderim Bajraktari

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **4,877.00 €**, (*kater mij e teteqind e shtatedhjet e shtate Euro*).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *[punëve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *[punëve]*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[te kryej ndonjë ose të gjitha punët]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *[punëve]* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *[specifiko gjykatën kompetente]* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi



14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.



E hartuar në gjuhen [Shqip] [Serbisht] [Anglisht] ¹ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Jetmir Zenelaj B.I.- (N.N.P.” KALAJA”) Suhareke	Emri:	Nuro Ismaili
Pozita:	<i>menagjer</i>	Pozita:	<i>102</i> Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.09.2020.	Data:	14.09.2020.
Vula:		Vula:	

¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

Shkolla Buge
(Gjithrin. Hredug)


PARAMASA E PROJEKTIT: RENOVIMI I SHKOLLËS FILLORE NË FSHATIN BUQE	
A PUNËT PËRGATITORE	

Përshkrimi i punimeve		Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Punëmarrësi është i detyruar që para fillimit të punimeve të bëjë rrethimin e punishtës, t'i montoj barakat montazhe (kontejnerët) për punëtorët dhe organin mbikqyrës. Pas përfundimit të punimeve të njëjtat duhet të largohen dhe të bëhet pastrimi i objektit dhe terrenit rreth objektit në tërësi.	komplet	1	1.00	1.00 €
2	Furnizimi me ambalazh mbrojtës dhe paketimi me kujdes i gjeseve me vlerë në zonë ku do të rinovohet, duke përfshirë bartjen dhe lëvizjen e mobiljeve ekzistuese duke u kujdesur që mos lëndohen dhe kthehen në gjendje të mëparshme pas përfundimit të punimeve. Mobiljet si dhe gjerat me vlerë të ambalazuara gjatë kryerjes së punimeve duhet të depozitohen (Magazhohen) në zonë të sigurtë. Vërejtje: Çdo dëmtim eventual të gjerave me vlerë të orendive gjatë zhvendosjes/lëvizjes nga pakujdesia e punëtorve mbetet përgjegjësi e Operatorit Ekonomik që ta kompenzoj dëmtin.	komplet	1	1.00	1.00 €

Gjithsej punët përgatitore: 2.00 €


B PUNËT E DEMOLIMIT	
---------------------	--

Përshkrimi i punimeve		Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Punëmarrësi është i detyruar që të gjitha materialet e demoluara (sipas pos. të poshtëshënuara) t'i largojë nga punishja apo t'i transportojë deri në deponinë e caktuar për depozitim materiale. Materialet që i nevojten Autoritetit Kontraktues duhet të deponohen në depot e parapara për grumbullim të materialit në depot e Komunës. Demontimi i trupat ndriqes ekzistues poqeve fluroshente, me qellim të zëvendësimit të tyre me llamba LED. Në qrim duhet të llogaritet demolimi edhe priza, ndërprerësve si dhe bartja e materialit të demontuar deri në deponi.	copë	30.00	0.50 €	15.00 €



2	Demolimi i dyshemeve ekzistuese në koridore , klasët dhe sallën e arsimitareve. Në çmim duhet të llogariten edhe largimi i llajsneve dhe bartja e materialit deri ne deponi.	m ²	190.00	0.50 €	95.00 €
3	Demolimi - gërryerja e pandimit (gjetimit), ngjyrës ekzistuese në mure dhe plafone sipas nevojës, si dhe bartja e materialit të demoluar deri ne deponi më të afërt.	m ²	640.00	0.30 €	192.00 €

	Gjithsej punët e demolimit	302.00 €
--	----------------------------	----------



C	PUNËT E DYSHEMESE
---	-------------------

Përshkrimi i punimeve				
	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali

1	Furnizimi me material dhe shtruarja e estrit betonit d=5cm. Në çmim të llogaritet edhe stropori i presuar N4 me trashësi prej 5cm si dhe PVC-folja.	m ²	190.00	6.00 €	1,140.00 €
2	Punimi i dështimeve të klasës dhe korridoreve me pllaka linoeumi me trashësi 4 mm me ngjyrë të hirtë. Në çmim është përfshirë edhe punimi i cokllës në vijë-takimet e mureve perimetrike. Punimi të bëhet sipas udhëzimeve të prodhuesit.	m ²	190.00	11.00 €	2,090.00 €
3	Furnizimi, transporti dhe montimi i Laminatit i Klasit të parë t= 12 mm në sallën e arsimtarëve.	m ²	60.00	7.00 €	420.00 €

Gjithsej punët e dështimeve:				
				3,650.00 €

D PUNËT E INSTALIMEVE ELEKTRIKE


Për secilin pozicion parashihet blerja dhe sigurimi i materialit, egzekutimi i punimeve si në përshkrimin e dhënë në pozicion, funksionaliteti dhe lëshimi i atesteve të nevojshme për materialet e përdorura.

Grupat ndriqes, prizat, ndërprerësat dhe tasterët				
	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali

1.1	Llampa LED me dimensione (600x600)mm për vendosje në plafone të rrafshët. Llampa është e ndërtuar nga lamarina e ngjyrosur me ngjyrë të bardhë me proces të plastifikimit. Llampa ka fuqi 50w dhe jep ngjyrë ditorë 4200K. Llampa përdoret për ndriçimin e hapësirave të klaseve parashkollore dhe sallës edukatës fizike.	copë	12	8.00 €	96.00 €
1.2	Llampa e plafonit me poq LED 22w. Llampa përdoret për ndriçimin e koridoreve dhe shkollave	copë	8	5.00 €	40.00 €
1.3	Llampa e plafonit me poq E27, LED 15w, IP65 dhe me sensorë të lëvizjes. Llampa përdoret për ndriçimin e kthinave. Llog në copë me të gjitha shpenzimet	copë	4	5.00 €	20.00 €
1.4	Llampë anupanike 3w LED me akumulatortë vetanak që rezervojnë energji elektrike 3 orë mbrenda 24 orëve	copë	6	8.00 €	48.00 €
1.5	Nderpres të thjeshtë 10A dy modulësh për vendosje në murë	copë	12	3.00 €	36.00 €



1.6	Nderpres alternativ 10A për vendosje në murë dy modulësh.	copë	12	3.00 €	36.00 €
1.7	Shteqe njëfazore dymodulëshe me kontakt për përrokzim për vendosje në murë (10-16)A	copë	12	3.00 €	36.00 €
1.8	Shteqe njëfazore njëmodulëshe për vendosje në murë (10-16)A	copë	12	3.00 €	36.00 €
1.9	Kuti dymodulare e plastikës e kompletuar me kornizë metalike dhe bulona për vendosje te shteqeve ose nderpresve.	copë	12	3.00 €	36.00 €
1.10	Kuti katërmodulare e plastikës e kompletuar me kornizë metalike dhe bulona për vendosje te shteqeve ose nderpresve.	copë	12	3.00 €	36.00 €
1.11	Kuti tetërmodulare e plastikës e kompletuar me kornizë metalike dhe bulona për vendosje te shteqeve ose nderpresve.	copë	12	6.00 €	72.00 €
1.12	Materiali i limitë për montim dhe lëshimi në punë për shkak të mungesës së projektit elektrikës tek objekti ekzistues i cili do të rinovohet, gjatë ekzekutimi punimeve mund të dalin punë të pa parapara të cilat do të llogariten komplet në funksionalitetin e objekti duke llogaritur të gjitha shpenzimet. Llog Komplet	komplet	1	10.00 €	10.00 €
1.13		komplet	1	1.00 €	1.00 €



	Gjithsej punët e instalimeve elektrike	503.00 €
--	--	----------

E PUNËT E NGJYROSJES

Përshkrimi i punimeve		Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Furnizimi me material dhe patinimi (gletimi) i mureve ne tri shtresa deri ne pregaditjen e siperfaqes per pranimin e ngjyres.	m ²	420.00	0.50 €	210.00 €
2	Furnizimi me materialit dhe patinimi (gletimi) i plafonit ne tri shtresa deri ne pregaditjen e siperfaqes per pranimin e ngjyres.	m ²	220.00	0.50 €	110.00 €
3	Furnizimi i materialit dhe ngjyrosja e mureve të korridorit dhe klaseve me ngjyrë ne tri shtresa deri ne lartësi h=1.2m. Te aplikohet ngjyra e yndyrshme e cila mund te mirembahet-pastrohet me ujë. Ngjyren e cakton organi mbikqyres.	m ²	60.00	1.00 €	60.00 €
4	Furnizimi, transportimi dhe ngjyrosja e mureve dhe plafoneve të këthave të brendshme dhe korridorit me ngjyrë dispersive. Ngjyren e cakton organi mbikqyres.	m ²	40.00	1.00 €	40.00 €
Gjithsej punët e ngjyrosjes					420.00 €

RENOVIMI I SHMFU RENOVIMI I SHKOLLËS FILLORE NË FSHATIN BUQE
RE KAPITULIM I P UNIMEVE

A	PUNËT PËRGATITORE	2.00 €
B	PUNËT E DEMOLIMIT	302.00 €
C	PUNËT E DYSHEMESË	3.650.00 €
D	PUNËT E INSTALIMEVE ELEKTRIKE	503.00 €
E	PUNËT E NGJYROSJES	420.00 €

GJITHSEJ PUNËT NDËRTIMORE ME TVSH	4.877.00 €
-----------------------------------	------------

